



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2025

VENDIM

Nr. 697, datë 17.10.2025

PËR

**PËRFUNDIMIN E KOHËZGJATJES SË KOMANDIMIT TË GJYQTARES
ZNJ. {...} NË POZICIONIN NDIHMËSMAGJISTRAT NË GJYKATËN E LARTË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61, 86, shkronja “d” dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 57, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. nr. 434, datë 14.10.2020, “Për komandimin e znj. {...} në pozicionin e “ndihmësmagjistratit”, në Gjykatës së Lartë”, nr. 477, datë 13.09.2023 dhe nr. 610, datë 16.10.2024 “Për konfirmimin si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë të gjyqtares {...}, dhe zgjatjen e mandatit të komandimit me 1(një) vit”, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin “ndihmësmagjistrat”, në Gjykatën e Lartë në fund të afatit të komandimit, më datë 20.10.2025.
2. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së komanduar znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si edhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
3. Kthimin e gjyqtares znj. {...} në pozicionin e mëparshëm në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR